



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. prot 15607

Tiranë 20/4 /2018

### NJOFTIM

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të shqyrtuar p/vendimet e paraqitura nga Bashkia e Tiranës, ditën e Enjte, datë 26.04.2018, ora 12:00, në sallën e Këshillit Bashkiak, me këtë rend dite:

1. P/Vendim “Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30.4.2018”.
2. P/Vendim “Për miratimin e pagesës për PAK e Invalidët e Punës për periudhën 1- 30 Prill 2018”.
3. P/Vendim “Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, për kategoritë përfituese, gjatë periudhës 1- 31 Mars 2018”.
4. P/Vendim “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018” (i ndryshuar).
5. P/Vendim “Për kalimin e administrimit të Parkut Rinia, si park rekreativ me gjithë elementët përbërës, nga Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit tek Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”.
6. P/Vendim “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të disa pronave të paluajtshme shtetërore, që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën arsimore, infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik”.
7. P/Vendim “Për përcaktimin e procedurës për negociimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet marrëveshjeve të sipërmarrjes/shkëmbimit për pronat në pronësi të saj”.

8. P/Vendim “Për kalimin në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, të disa pasurive në pronësi të Uzina e Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve (UNPA).
9. P/Vendim “Për përfshirjen e ekipeve të xhudos, kanotazhit dhe bilardos në organikën e Klubit Sportiv “Tirana”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”.
10. P/Vendim “Për kalimin e bandës frymore nga qendra kulturore “Tirana” pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit dhe “Një ndryshim në vendimin nr.8, datë 07.02.2017 të Këshillit Bashkiak “Për një ndryshim në mënyrën e pagesës për bandën dhe ansamblin folklorik të qendrës kulturore “Tirana””.
11. P/Vendim “Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e skulpturës të Helidon Xhixhës në sheshin “Karl Topia”.

#### MBLEDHJET E KOMISIONEVE

- **Komisioni i Strehimit dhe Çështjeve Sociale:**  
Komisioni do të shqyrtojë pikën 1, 2, 3 dhe do të mblidhet ditën e martë, datë **24.04.2018, ora 12:00.**
- **Komisioni i Arsimit dhe i Sporteve:**  
Komisioni do të shqyrtojë pikën 9 dhe do të mblidhet ditën e martë, datë **24.04.2018, ora 13:00.**
- **Komisioni i Kulturës, Turizmit dhe Figurave të shquara të qytetit:**  
Komisioni do të shqyrtojë pikën 11 dhe do të mblidhet ditën e martë, datë **24.04.2018, ora 14:00.**
- **Komisioni Juridik:**  
Komisioni do të shqyrtojë pikën 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **25.04.2018, ora 13:00.**
- **Komisioni i Financës, Ekonomisë dhe Nxitjes së Sipërmarrjes:**  
Komisioni do të shqyrtojë pikën 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **25.04.2018, ora 14:00.**

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

